

De Biasi justifikon zgjedhjet e tij

nga Administrator

E mërkurë, 01 Qershor 2016 13:56



Sot ne oren 12:00 tranjeri i kombetares De Biasi ka mbajtur konferencen per shtyp ne lidhje me zgjedhjen e 23 lojtareve qe do te jene pjese ne France 2016.

Tranjeri i eshte pergjigjur disa nga pyetjeve te gazetareve dhe eshte paraqitur i nervozuar gjate konferences. Ai ka justifikuar zgjedhjet e bera si edhe perse Rashica, Gjimshiti, Rrahmani dhe Shala nuk jane perfshire ne listen perfundimtare.

Per Gjimshitin u shpreh: "Per fat te keq Gjimshiti nuk eshte aktivizuar shume kete sezon". Nuk harroi te beje komplementet per Milot Rashicen i cili kete sezon eshte aktivizuar por justifikoj mos perfshirjen ne listen perfundimtare me faktin qe ai nuk ka qene i perfshire ne ndeshjet zyrtare. Por me siguri ai eshte ne planet e tij ne te ardhmen.

De Biasi foli edhe per ndeshjen e ardhshme miqesore kunder Ukraines. Ai pret qe ekipi te korigjoe gabimet e bere ne mbrojtje ndeshjet e kaluara si edhe te zhvilloje nje ndeshje te mire.